

DIVORCI TRADHTAR, ETËRIT E PËRKOHSHËM DHE DËRRMIMI I FAMILJES

FAKTI: *Mendoni se gjendja e rëndë ekonomiko-sociale në Maqedoni, papunësia dhe varfëria që janë në rritje, bën që shumë shqiptarë të martuar, në marrëveshje me gratë e tyre, të prishin kurorën dhe të kërkojnë një nuse nga shtetet e Bashkimit Evropian (BE), me të cilën do të vinin kurorë dhe do të rregullonin letrat e punës në ato vende evropiane?*

Pajaziti: Natyrisht se gjendja e rëndë socio-ekonomike ndikon që njerëzit të marrin vendime kaq kruciale siç është “divorci formal” ose i letrave për të emigruar gjoja përkohësisht në ndonjë vend evropian ose perëndimor me qëllim të “përmirësimit të gjendjes” sociale. Për njerëzit kafshata e gojës është kusht i domosdoshëm i jetesës por ama vendimi për të braktisur komunitetin e gjerë (shoqërinë amë) dhe atë të ngushtë (familjen) nuk do të duhej të ishin vendime kaq të përhapura dhe të lehta, sepse nderi individual dhe ai familjar janë komponentë shumë të rëndësishëm në kulturën tonë shqiptare që nuk shiten për asnjë pará. Shqiptari gjatë historisë ka kaluar batica e zbatica të shumta por asnjëherë s’ka lejuar që të thyejë besën e dhënë, mes tjerash edhe atë të kurorës, që është një besatim me peshë, dhe “prishja e dokumentave” është faktikisht një dilemë e madhe etike, një besëthyerje, në të shumtën e rasteve, një shmangie prej çerdhes së vërtetë në një çerdhe të rrejshme për të dyja palët, si atë ardhacake (shqiptari) dhe atë vendëse (nusja *de jure* nga ndonjë vend i BE-së), një vendim që sjell një duzinë problemesh të natyrave të ndryshme, nga ato juridike-administrative, deri te ato sociologjike-psikologjike. Mendoj se me këtë vendim nuk janë të kënaqur as pala që ofron shërbim (indigjenia evropiane) e as ajo që merr shërbimin (shqiptari), e më së paku femra e martuar shqiptare, e cila lihet në mëshirë të stihisë, pra të plotësojë zbrazëtirat e burrit ikanak që fiton për familjen, e në fakt paguan “tagrën” jolegjitime partneres së tij që “i mundëson atij të përmirësojë statusin ekonomik” dhe që e mban atë të varur në mënyrë permanente, që e kushtëzon me dëbime për çdo moment. Kjo është fotografia e përgjithshme, që s’do të thotë që s’ka përjashtime. Ka edhe lidhje të mirëfillta me “nuse evropiane”, pra që përfundojnë me dashuri të vërtetë, por prapë humb nusja e parë (shqiptarja), sepse tanimë fituesi i parave përqendrohet jetësisht te tjetra dhe mbetet me njërin gisht të këmbës te e para. Përvoja e shqiptarëve flet për një tablo të këtillë. Dhe një gjë: flisni për marrëveshje. Kjo marrëveshje është kontratë e imponuar, të cilën në mënyra shumë perfide pala mashkullore ia imponon asaj femërore shqiptare. Pra s’mund të flitet për marrëveshje por për njëfarë marramendjeje fjalësore-diskursive, pasojat e së cilës vërehen tek më vonë.

FAKTI: *Cili do të ishte shkaku kryesor që shumica e shqiptarëve të ardhmen e tyre ta shohin jashtë vendit, në shtetet perëndimore? Pse ata për të ardhur deri te dokumentat e qëndrimit në vendet e BE-së kërkojnë partnere nga ato vende?*

Pajaziti: Klima e përgjithshme pesimiste e bën të veten. Çdo ditë e më shumë njerëzit bombardohen me pashpresinë e së ardhmes, me një defetizëm të rrjetëzuar që bën që të filloni të dyshoni nëse po u lëkundet dhe nën këmbë. Sipas Gallup Balkan Monitor 46 % e qytetarëve të këtij

vendi (Maqedonisë), por edhe ata të trojeve të tjera shqiptare, mbeten të pakënaqur me kualitetin e jetesës së tyre dhe kjo ka impaktet e veta, ndër të cilat është edhe mobiliteti social horizontal, pra lëvizja ose shpërngulja prej një vendi në tjetrin, kërkimi i jetës më të mirë (!), i shoqërisë së ëndrrave, kur “rrjedh qumësht e mjalt”, pra utopia e quajtur Perëndim, ku fitimi më nuk është si dikur, natyrisht më i mirë se këtu por krahasuar me të kaluarën, më tepër përkufizohet si hapësirë për jetesë më të mirë sesa për fitim dhe kursim për investime në atdhe. Rol luan edhe imitimi i verbër, mashtrimi me aparençën e kurtbetqarëve (si makinat, shtëpitë etj.), pa menduar se njerëzit me dekada të tëra kanë investuar mundin e tyre, se s'i kanë fituar me një shkop magjik. Njerëzit harrojnë pasojat, mendojnë vetëm për rezultatet. S'çan kush kokën për “tronditjen kulturore”, për lëkundjen identitare si dhe shumë gjëra të tjera që s'i ka diku larg tokës “ku e njeh edhe guri i thatë”.

FAKTI: Mendoni se odiseadat e këtilla për të siguruar një jetë të mirë për familjen, shpesh bëjnë çrregullime familjare?

Pajaziti: Po, gjithsesi. Indi familjar po merr një grusht të fortë nga fenomenet e këtilla, nga odiseadat më reperkusione lëkundëse-traumatike. Lëre se gratë mbeten pa shtyllën kyç familjare (e vërtetë edhe përkundër *vox feminicus*), edhe fëmijët mbeten pa etërit e tyre dhe janë të detyruar që të rriten pa e ditur shprehjen baba real, sepse kurorëlidhësit me të huajat janë etër virtualë, që nganjëherë u dëgjohet zëri në telefon e nganjëherë vijnë për të thënë dhe për të treguar se janë me familjen, ndërsa faktikisht janë në një botë të tyre shumë larg gjirit familjar, me *double* obligime, që s'ia dalin t'i përmbushin sa duhet. Në këtë kohë është rëndë që të mbash perët në duar duke qenë pranë familjes e jo me mijëra kilometra larg. Kështu paraqitet problemi i socializimit të fëmijëve, i turbulencave dhe tragjediave familjare që për një jetë më të mirë dështojnë në shumë aspekte të jetës, humbin stabilitetin e tyre dhe shndërrohen në ambiente të hidhëtisë dhe dredhirave. Është shumë interesant fakti se francezët këta baballarë i quajnë *peres demmissionaries*: baballarë në dorëheqje, kurse anglezët *temporarily fathers*, etër të përkohshëm që për shkak të preokupimeve të shumta profesionale dhe jetike me fëmijët e tyre takohen rrallë, që mashtrojnë fëmijët e tyre duke u blerë lojëra, veshmbathje e sheqerka, që mundohen të përfitojnë dashurinë e tyre me gjëra materiale.

FAKTI: Vlerësoni se shkurorëzimet të shqiptarët rreth kësaj çështje në Maqedoni shënojnë një rritje të vazhdueshme?

Për fat të keq nuk disponojmë me të dhëna statistikore ekzakte që do të na jepnin një pasqyrë të qartë lidhur me këtë gjendje postmoderne (*postmodern condition*), por ama nga bisedat me njerëz dhe nga refleksionet shoqërore, fitohet përshtypja se ky trend ka marrë vijën e ngritjes lart, pra po zgjerohet në rrafshin shoqëror dita-ditës. Të gjithë parametrat flasin se kocka është hedhur, bindja për pathyeshmërinë e familjes është thyer dhe me të hapur të shtegur njerëzit inkurajohen për të bërë hapin “drejt pasurimit”, pa menduar mirë rreth reperkusioneve dhe përvojës së atyre që veç më kanë shijuar ujërat e bashkëjetesës me nusët që u paguhet një sasi e majme parash për të aktruar nusërinë dhe nënërinë, të cilën shpeshherë as që e shijojnë me kurbetqarët tanë, por takohen me ta vetëm në kohën e pagesës së kësteve ose të totalit. Le të theksojmë se kjo tablo që dhamë nuk vlen për tërë kurbetërinë shqiptare, por jep një vështrim sociologjik të gjendjes reale të një pjese të veçantë të kësaj bashkësie imigrante. Si gjithëherë edhe lidhur me këtë dukuri, koha do të tregojë të vërtetën!

Intervistoi: Fami Bajrami